



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.39, datë 26.12.2023

PËR

MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“STRUKTURË SHËRBIMI (BUJTINË) DRURI 1 KAT DHE NJËSI AKOMODUESE  
DRURI 1 KAT ME VENDODHJE NË FSHATIN MURTH, NJËSIA ADMINISTRATIVE  
DAJT, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të neneve 27, 28 dhe 40, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Z. Idriz Hysa, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit të objektit: “Strukturë shërbimi (bujtinë) druri 1 kat dhe njësi akomoduese druri 1 kat me vendndodhje në fshatin Murth, njësi administrative Dajt, Bashkia Tiranë”, me zhvillues Z. Idriz Hysa, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.17, datë 28.07.2020.
2. Afati i kryerjes së punimeve sipas këtij Vendimi, do të pasqyrohet në Dokumentin e Lejes së Ndërtimit, në përputhje me afatin e përcaktuar në grafikun e punimeve.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.17, datë 28.07.2020 “Strukturë shërbimi (bujtinë) druri 1 kat dhe njësi akomoduese druri 1 kat me vendodhje në fshatin Murth, njësi administrative Dajt, Bashkia Tiranë”, nuk ndryshon.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT DHE MËDISIT  
MIRELA KUMBARO FURXHI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA

A blue circular official stamp from the Agency for Territorial Development, Ministry of the Prime Minister. The text around the perimeter reads "REPUBLIKA E SHQIPËRIE" at the top, "AGJENCIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT" on the sides, and "MINISTRIA E KRUEMINISTRIT" at the bottom. A signature and the number "23" are written over the stamp.

Nënskruar më datë 28 / 12 / 2023